



**Projekti teknik**  
**Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik**  
**“Mbreteresha Geraldine”**



**Tirane, Shkurt 2017**

## **Qellimi i raportit te Vleresimit paraprak te Ndikimit ne Mjedis**

Qellimi i raportit paraprak te VNM eshte te analizoje veprimtarine spitalore te SUOGJ Mbreteresha Geraldine, duke identifikuar impaktet e mundshme ne mjedis dhe te propozoje masat per shmangien dhe/ose minimizimin e ketyre impakteve.

Kuadri ligjor per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis konsiston ne dy ligje per mjedisin ne Shqipëri: Ligji “Per mbrojtjen e mjedisit” dhe Ligji “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”, te perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit Europian per mbrojtjen e mjedisit dhe Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.

Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 Per lejet e mjedisit, ne Aneksin Nr.1 , veprimtaria e SUOG “Mbreteresha Geraldine” klasifikohet ne listen e aktiviteteve qe duhet te paisen me leje mjedisore te tipit B aktivitetin e menaxhimit te mbetjeve spitalore.

Ligji “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM)” percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM.

Kategoria e VNM-se per aktivitetin e SUOGJ “Mbreteresha Geraldine” klasifikohet si aktivitet qe kerkon VNM paraprake. Bazuar ne dispozitat e ligjit VNM paraprake aplikohet per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

Kuadri ligjor kombetar ne lidhje me aktivitetin dhe mjedisin perfshin:

- Ligjin nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
- Ligjin nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”;
- Ligjin nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”
- Ligjin nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, te ndryshuar
- Ligjin nr. 8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
- Ligjin nr.9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, te ndryshuar;
- Ligjin nr. 37/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligjin Nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”
- Ligjin Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë

04.02.2008;

- VKM Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”;
- VKM Nr.247, datë 30.04.2014 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”;
- VKM Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”;
- VKM Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”
- VKM Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”;
- VKM Nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”;
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”
- VKM Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla të tjera”
- VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per Miratimin e rregullave përgjegjesive e të afateve për zhvillimin e procedurës së VNM-së”
- VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.
- VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror”;
  - Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: “Për ratifikimin e protokollit të vleresimit strategjik mjedisor”.



### **Vendndodhja dhe pershkrimi i aktivitetit**

Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretresha Geraldine”, ndodhet ne njesine bashkiake nr. 9 ne Tirane, ne Bulevardin “Zogu I”, i cili kryqezohet me rrugen e unazes se Tiranes. Zona ku eshte lokalizuar spitali eshte nje zone urbane me aktivitet tregtar ne zhvillim, dhe me nje mjedis me trafik urban. Ne afersi te spitalit ndodhet ish Stacioni i Trenit ndersa perballe tij ndodhet Fakulteti i Shkencave te Natyres.

Për sa përket mbejteve spitalore spitali ka pike grumbullimi të këtyre mbetjeve brenda standarteve, ndersa procesi tërheqjes dhe trjatimit të tyre bëhet nga një kompani e specializuar në këtë fushë “Euroteam” shpk.

Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretresha Geraldine” siguron nevojat per energji elektrike nepermjet rrjetit te energjise elektrike dhe ne mungese te tij nepermjet gjeneratorit automatik me naftë, **me fuqi 250kva.**



Koordinatat e vendndodhjes se SUOGJ “Mbretresha Geraldine”

	E	N
1	4401156.78	4578591.90
2	4401170.18	4578514.31
3	4401108.49	4576540.04
4	4401110.29	4578503.04

Kapaciteti i shtretërve në SUOGJ “Mbretresha Geraldine” është 236 shtretër.

Repartet e spitalit janë në kushtë të mira, sipas ndarjes se mëposhtme:

- Reparti i gjinekologjise,
- Reparti i obstetrikes
- Reparti i reanimacionit neonatal,
- Reparti i reanimacionit te grave,
- Reparti i rrezeve X,
- Sallat e operacionit te obstetrikes,
- Sallat e operacionit te gjinekologjise
- Laboratori biokimik
- Laboratori mikrobiologjik
- Laboratori histopatologjik
- Laboratori i kerkimeve gjenetike,

- Farmacia e Spitalit,
- Qendra e gruas,
- Patologjia e barres
- Banka e gjakut
- Administrata.

Spitali garanton mbrojtjen e shendetit te grave, te porsalidurve (nenonatit) nepermjet:

- Sherbimit te pandërprere 24 ore me personel mjekesor te kualifikuar per te gjitha sherbimet e lidhura me shendetin e nenes dhe te porsalidurve;
- Farmacise qe ploteson kriteret dhe kushtet ndertimore dhe ato te ruajtjes se barnave sipas percaktimeve te Ligjit nr. 9323 date 25.11.2004 "Per barnat dhe sherbimin farmaceutik", te ndryshuar;
- Labororit klinik, biokimik, mikrobiologjik, bakterologjik, imunologjik te specializuar;
- Njesive te sterilizimit;

### **Menaxhimi dhe magazinimi i mbetjeve ne SUOGJ "Mbreteresha Geraldine"**

Në SUOGJ "Mbreteresha Geraldine" gjenerohen mbetje spitalore dhe mbetje urbane menaxhimi i te cilave realizohet nepermjet:

Aktualisht largimi i mbetjeve mjekesore realizohet nepermjet :

- Trajtimit te tyre ne hidroklaven e instaluar ne qendren spitalore;
- Largimit dhe asgjesimit nga subjekti "EUROTEAM shpk" me te cilin SUOGJ "Mbreteresha Geraldine" ka kontrate (kontrata bashkelidhur dokumentacionit).
- Mbetjet urbane largohen dhe asgjesohen nga subjekti SILVIO shpk sipas kontartes se nenshkruar.

Skema e aktivitetit të shërbimit të administrimit të mbetjeve spitalore përfshin: mbledhjen, transportin e përshtatshëm nga vendi ku është bërë ndarja e tyre, magazinimi i mbeturinave në vende të posaçme që plotësojnë kushtet për magazinim të tyre. Transportimi i mbeturinave nga vendet ku janë magazinuar në trajtimin përfundimtar, dhe asgjesimin e tyre.

Djegia e mbetjeve te rrezikshme mjekesore ka pasoja te rreziqeve mjedisore per shkak te emetimit te gazeve toksike potenciale dhe prandaj ne SUOGJ Mbreteresha Geraldine, qysh prej vitit 2006, po zbatohen praktikat e trajtimit te mbetjeve mjekesore nepermjet Hidroklaves.

Impianti (hidroklava) është vendosur në një nga ambientet e spitalit dhe kryen, që prej kësaj kohe, trajtimin e mbetjeve mjekësore. Ky trajtim konsiston në sterilizimin e mbetjeve të rrezikshme mjekësore që gjenerohen, duke i kthyer ato në mbetje që nuk përbejnë rrezik për shëndetin dhe mjedisin të cilat me pas mund të depozitohen në vende të caktuara.

Praktikat e menaxhimit të mbetjeve mjekësore që gjenerohen nga SUOGJ janë përmirësuar gradualisht në pesë vitet e fundit për të mundësuar menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta spitalore dhe të atyre mjekësore.

Duke njohur këtë nevojë, sigurimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve mjekësore bëhet që prej vitit 2010, bazuar në parimin e përdorimit të hidroklaves. Kjo teknologji është shumë efektive në sterilizimin e mbetjeve mjekësore, duke siguruar që mbetja nuk është më e "rrezikshme" dhe për më tej mund të sistemohen në mënyrë të sigurtë në një vend-depozitim.

Instalimi i implantit për përpunimin e mbetjeve mjekësore (Hidroklava) është bërë brenda një ndërtese ekzistuese, në krah të lavanderisë së spitalit.

Ky lloj trajtimi i mbetjeve mjekësore është propozuar si një opsion për të siguruar ruajtjen e shëndetit të punonjësve dhe të atyre që trajtojnë mbetjet si dhe për të përmirësuar izolimin e mbetjeve potencialisht të rrezikshme nga pacientet dhe publikun në përgjithësi.

Menaxhimi i suksesshëm i mbetjeve kërkon një bashkëpunim në mes të ofruesit të shërbimit dhe spitalit. Në këtë drejtim, kompania ka asistuar spitalin për të identifikuar dhe për të menaxhuar dhomën e freskët të magazinimit në spital. Kompania do të minimizojë grumbujt e mbetjeve në spitale duke siguruar që mbetjet të mblidhen të paktën 1 herë në ditë. Kur spitali ka me shumë ngarkesë punë mbetjet ë mblidhen më shpesh.

Gjithashtu dërgohen konsulentë marketingu për të vizituar spitalet një herë në dy javë për të evidentuar problemet që mund të dalin gjatë kohës.

### **Grumbullimi i mbetjeve**

Kompania e cila ka marrë përsipër shërbimin e mbledhjes së mbetjeve, ka furnizuar spitalin me kontenerët e nevojshme për mbetjet dhe do të realizojë ndarjen e mbetjeve si më poshtë:

- o Nr 1 – produktet e mprehta dhe ruhen në konteneret e produkteve të mprehta;
- o Nr 2 - mbetjet infektive ruhen në qese të mbeturinave;
- o Nr 3 – mbetjet anatomike ruhen në kontenerë anatomike;
- o Nr 4 – mbetjet farmaceutike ruhen në kutitë e dhëna nga prodhuesi dhe
- o Nr 5 - mbetjet radioaktive

Kur qeset ose kontenierë janë mbushur ato mbyllen me mënyrën e përcaktuar dhe hapen vetëm në vendin e përpunimit.

Hidroklava, si impiant trajtimi i mbetjeve mjekësore është shumë efektive, kryen sterilizimin dhe inaktivimin e ngarkesës mikrobiale me të madh se  $10^6$ , që do të thotë se mbetja është 99,99% e sterilizuar dhe nuk është më e rrezikshme para largimit në vend depozitim.

Avulli brenda enes gjenerohet nga përmbajtja e lagështisë brenda vetë mbeturinave. Gjatë procesit, mbetjet përzihen dhe shtypen nga një rotor me krahe copetues, duke e shpërndarë nxehtësinë në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë ngarkesën. Ky veprim than mbetjet dhe nxehtësia largon lagështinë, dhe avulli i thatë clirohet përmes një nga daljet.

Ngrohja dhe përzierja e avullit vazhdon deri sa të gjithë lëngjet e mbetjeve të kenë avulluar dhe mbetja të jete e thatë. Ky cikël zgjat rreth 30 minuta, dhe pas përfundimit, mbetja është krejtësisht e panjohur, pluhur i thatë dhe që përbëhet vetëm nga 20 deri në 30% e vëllimit të saj origjinal.

### **Kriteret për menaxhimin mjekësor:**

- Spitali garanton të drejtat e pacientit, informon për procedurat mjekësore diagnostikuese, kuruese për të proceduar me aprovim/miratimin e tij për t'ju nënshtruar procedurave.
- Spitali ofron shërbim 24/ore me personel mjekësor të kualifikuar për të gjitha shërbimet për të cilat kërkohet licensimi.
- Spitali ka një farmaci që plotëson kriteret dhe kushtet ndërtimore dhe ato të ruajtjes së barnave sipas përcaktimeve të Ligjit për barnat dhe shërbimin farmaceutik, të ndryshuar.
- Spitali ka një laborator klinik, biokimik, mikrobiologjik, bakterologjik, imunologjik të cilat janë në përputhje me nevojat e Spitalit.
- Spitali disponon njësi sterilizimi.
  - Për mbetjet Spitalore të prodhuara nga aktiviteti mjekësor zbatohet legjislacioni kombëtar për eliminimin e mbetjeve spitalore (sipas kontratës midis SUOGJ Mbreterësia Geraldine & Kompanisë Euroteam shpk).
  - Për mbrojtjen nga infeksionet spitali ka një program për reduktimin e rrezikut.